

FORMULAR INFORMIMI MBI FAKTET E ÇRREGULLIMIT ZHVILLIMOR TË GJUHËS (ÇZhGj)

Tre gjëra që duhet të dini në lidhje me ÇZhGj

1. Çrregullimi Zhvillimor i Gjuhës (angl. Developmental Language Disorder) ndodh kur një fëmijë ose një i rritur ka vështirësi në të folur dhe/ose në të kuptuarit e një gjuhe.
2. ÇZhGj është një çrregullim i fshehur që prek afërsisht 1 në 14 fëmijë, duke ndikuar aftësinë e të mësuarit, të miqësisë dhe të mirëqenies emocionale.
3. Mbështetja nga profesionistët, përfshirë logopedët, terapistët e gjuhës dhe mësuesit, mund të ofrojë një ndihmë të vërtetë.

ÇZhGj: Terminologjia diagnostike, shpeshtësia, shkaqet

- **Konsensusi mbi terminologjinë:** Rekomandimi për përdorimin e termit diagnostikues Çrregullimi Zhvillimor i Gjuhës është publikuar nga (Bishop dhe të tjerë, 2016; 2017), shoqëruar nga një shpjegim se si u arrit kjo dakortësi.
- **Shpeshtësia:** ÇZhGj prek afërsisht 1 në 14 fëmijë. Një studim epidemiologjik i kohëve të fundit në Mbretërinë e Bashkuar, studimi SCALES (Norbury dhe të tjerë, 2016), zbuloi se 7.5% e fëmijëve shfaqnin ÇZhGj pa pasur lidhje me ndonjë gjendje bio-mjekësore.
- **Shkaqet:** ÇZhGj ka tendencë të rrjedhë në familje. Studimet mbi binjakë tregojnë një ndikim të fortë gjenetik në ÇZhGj, por kjo duket se reflekton më shumë në një ndikim të kombinuar midis gjeneve, sesa në një mutacion specifik (Bishop, 2006). Këndvështrimi i përhapur se ÇZhGj shkaktohet nga prindërit që nuk u flasin fëmijëve të tyre nuk ka asnjë mbështetje empirike.
- **Neurobiologjia:** Nuk ka asnjë provë për **ndonjë** dëmtim të trurit në shumicën dërrmuese të rasteve; mund të ketë ndryshime minimale në madhësinë e zonave të ndryshme të trurit dhe përqindjen e lëndës gri, por ky konstatim nuk është i qëndrueshëm nga fëmija në fëmijë. Deri më tani nuk ka asnjë tregues 'biometrik' për ÇZhGj (Leonard dhe të tjerë, 2006).

ÇZhGj: Vështirësitë e ndërlydhura

- **Marrëdhënia me situatat e tjera:** ÇZhGj ndodh zakonisht në kombinim me ÇPVH (Çrregullime të Pamjaftueshmërisë së Vëmendjes dhe Hiperaktivitetit – angl. ADHD) dhe disleksinë. Ka pasur shumë debate për mbivendosje me formën e butë të autizmit (Bishop, 2008). Shumë fëmijë nuk shfaqin problemet sociale karakteristike për autizmin, por disa shfaqin veçori të buta autike. Sidoqoftë, ekziston një ndryshim i dukshëm midis ndihmës së ofruar në dispozicion të fëmijëve me autizëm kundrejt fëmijëve me ÇZhGj. Ky ndryshim vazhdon deri në moshën madhore, ku si disleksia ashtu edhe autizmi njihen si paaftësi, ndërsa ka shumë pak ndërgjegjësim për ÇZhGj.

Aftësitë e të mësuarit dhe arritjet akademike: Ekzistojnë lidhje të ngushta midis ÇZhGj dhe disleksisë (Bishop dhe Snowling 2004). Shumë fëmijë me ÇZhGj plotësojnë kriteret për disleksi (McArthur dhe të tjerë, 2000). Edhe nëse fëmija mund të lexojë me zë të lartë dhe me saktësi, shpesh paraqet probleme me të kuptuarit e asaj që lexon (Stothard dhe të tjerë, 2010). Këto probleme shpesh anashkalohen, dhe vështirësia e të kuptuarit nga ana e fëmijëve, mund të keqinterpretohet nga mësuesit dhe të konsiderohet dembelizëm ose mungesë vëmendjeje. Mësuesit, gjatë edukimit të tyre, nuk kanë mësuar mbi ÇZhGj.

- **Vështirësitë sociale me bashkëmoshatarët:** Të jesh i aftë të shprehesh rrjedhshëm dhe të kuptosh shpejt ato që të tjerët thonë mund të kenë një ndikim të madh në marrëdhëniet shoqërore. Studimi gjuhësor i Mançesterit (angl. Manchester Language Study) zbuloi se deri në moshën 16 vjeç, 40% e individëve të diagnostikuar me ÇZhGj kishin vështirësi në bashkëveprim me bashkëmoshatarët e tyre (St. Clair, Pickles, Durkin & Conti-Ramsden, 2011), 50% e fëmijëve 16 vjeç shprehen se ishin ngacmuar në fëmijëri (në krahasim me më pak se 25% të adoleshentëve me zhvillim të zakonshëm) dhe 13% kanë përjetuar ngacmim të vazhdueshëm që nga fëmijëria. (Knox & Conti-Ramsden 2003). Të kuptuarit sa më mirë i ÇZhGj nga të rriturit dhe bashkëmoshatarët mund të ndihmojë në shmangien e këtyre rezultateve negative.

ÇZhGj: Punësimi dhe Shëndeti Mendor

- **Punësimi:** ÇZhGj duhet të merret seriozisht sepse mund të rrisë rrezikun e papunësisë dhe mungesës së pavarësisë në moshën madhore (Conti-Ramsden & Durkin, 2008). Sidoqoftë, individët me probleme të një shkalle më të ulët, shpesh janë të punësuar, por zakonisht në vende pune të një natyre relativisht të pakualifikuar (Whitehouse dhe të tjerë, 2009). Njohja më e mirë e ÇZhGj në shkolla do të lejonte zhvillimin dhe nxitjen e aftësive të fëmijëve, duke mos marrë lënë në indiferentizëm fëmijët të cilët nuk arrijnë rezultate të larta akademike.
- **Shëndeti Mendor:** Fëmijët me probleme të një shkalle më të ulët të ÇZhGj shfaqin më pak vështirësi. Nga ana tjetër, afërsisht dy të tretat e fëmijëve (64%) me çrregullim të vazhdueshëm gjuhësor shfaqin **disa** sjellje të jashtme (p.sh. problem me sjelljen: agresion 'përleshje me fëmijët e tjerë') dhe/ose vështirësi të brendshme (p.sh. tërheqje: vetmi, tendencë të luajë vetëm) (Conti-Ramsden & Botting, 2004). Për fat të mirë, këto vështirësi shpesh zgjidhen në adoleshencë (St. Clair dhe të tjerë, 2011), megjithatë, adoleshentët me ÇZhGj janë dy herë e gjysmë më shumë të predispozuar të shfaqin simptoma të depresionit krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre me zhvillim të zakonshëm (Conti-Ramsden & Botting, 2008). Shumica e terapive lidhur me problemet e shëndetit mendor të fëmijëve janë 'terapi biseduese' të cilat mund të mos jenë të përshtatshme për fëmijët me ÇZhGj.

ÇZhGj: Ndërhyrjet

- **Ndërhyrje:** Që ndërhyrjet të jenë efektive, ato duhet të jenë të një cilësie të lartë dhe me kohëzgjatje të mjaftueshme - janë zhvilluar një numër në rritje i ndërhyrjeve premtuese (Law dhe të tjerë, 2015). Vërtetë, gjykime të kontrolluara të rëndësishme në shkolla kanë treguar se ndërhyrjet e bëra nga mësuesit ndihmës, të cilët janë të trajnuar dhe mbështeten, mund të sjellin përfitime të konsiderueshme në Gjuhë (Fricke dhe të tjerë, 2013; 2017; 2017) dhe në aftësinë e të mësuarit (Bowyer-Crane dhe të tjerë, 2008). Disa fëmijë, me gjithë ndërhyrjet, do të kenë nevojë për mbështetje më afatgjatë për problemet që ata paraqesin (Boyle dhe të tjerë, 2010). Hulumtimi ka hasur vështirësi të veçanta të ndërhyrjeve me fëmijët me vështirësi receptive.

ÇZhGj: Njohja publike dhe fushata e Rritjes së Ndërgjegjësimit për Çrregullimin Zhvillimor të Gjuhës (angl. RADLD)

- **Historia dhe terminologjia:** Problemet gjuhësore të fëmijëve janë përshkruar për gati 200 vjet (Gall 1822). 'Afazia zhvillimore' ishte termi origjinal i përdorur, por më pas janë përdorur shumë terma të ndryshëm (dëmtim specifik gjuhësor, vështirësi fillestare gjuhësore) në kërkime dhe çështje praktikë (Dockrell, 2006). Termi Çrregullimi Zhvillimor i Gjuhës përdoret për shumë vite, por rekomandimet e reja të botuara në vitin 2017 japin udhëzime të qarta se si duhet të përdoret dhe shpjegojnë pse preferohet krahas terminologjive të tjera.
- **Nevoja për njohje më të mirë publike të ÇZhGj-së.** Ekziston një ndërgjegjësim i dobët i publikut për këtë gjendje, i reflektuar edhe në shkallë të ulët mbi studimet përkatëse në lidhje me shpeshësinë dhe ashpërsinë e

ÇZhGj (Bishop, 2010). Fushata RrNÇZhGjr (angl. RADLD), dikur (RALLI, Raising Awareness for Language Learning Impairments), lufton për të rritur ndërgjegjësimin e fakteve themelore në lidhje me ÇZhGj përmes një kanali në YouTube, faqeve të internetit dhe materialeve mbështetëse.

References

- Bishop, D. V. M. (2006). What causes specific language impairment in children? *Current Directions in Psychological Science*, 15, 217-221.
- Bishop, D. V. M. (2008). Specific language impairment, dyslexia, and autism: Using genetics to unravel their relationship. In C. F. Norbury, J. B. Tomblin & D. V. M. Bishop (Eds.), *Understanding developmental language disorders: from theory to practice* (pp. 67-78). Hove: Psychology Press.
- Bishop, D. V. M. (2010). Which neurodevelopmental disorders get researched and why? *PLOS One*, 5(11), e15112.
- Bishop, D. V. M., Clark, B., Conti-Ramsden, G., Norbury, C. F., & Snowling, M. J. (2012). RALLI: An internet campaign for raising awareness of language learning impairments. *Child Language Teaching & Therapy*, 28(3), 259-262. doi:10.1177/0265659012459467. pdf here: <http://journals.sagepub.com/doi/pdf/10.1177/0265659012459467>
- Bishop, D. V. M., & Snowling, M. J., (2004) Developmental Dyslexia and Specific Language Impairment: The same or different? *Psychological Bulletin*. 130 (6), 858-886.
- Bishop, D. V. M., Snowling, M. J., Thompson, P. A., Greenhalgh, T., & The CATALISE Consortium. (2016). [CATALISE: a multinational and multidisciplinary Delphi consensus study](#). Identifying language impairments in children. *PLOS One*, 11(7), e0158753. doi:10.1371/journal.pone.0158753
- Bishop, D. V. M., Snowling, M. J., Thompson, P. A., Greenhalgh, T., & The CATALISE Consortium. (2017). [Phase 2 of CATALISE: a multinational and multidisciplinary Delphi consensus study of problems with language development: Terminology](#). *Journal of Child Psychology & Psychiatry*. doi:10.1371/journal.pone.0158753
- Boyle, J., McCartney, E., O'Hare, A., & Law, J. (2010). Intervention for mixed receptive-expressive language impairment: a review. *Developmental Medicine and Child Neurology*, 52(11), 994-999. doi:10.1111/j.1469-8749.2010.03750.x
- Bowyer-Crane, C., Snowling, M.J., Duff, F.J., Fieldsend, E., Carroll, J.M., Miles, J., Götz, K., & Hulme, C. (2008) Improving Early Language and Literacy Skills: Differential Effects of an Oral Language versus a Phonology with Reading Intervention. *Journal of Child Psychology & Psychiatry*, 49, 422-432
- Conti-Ramsden, G., & Botting, N. (2004). Social difficulties and victimization in children with SLI at 11 years of age. *Journal of Speech, Language, and Hearing Research*, 47, 145-161.
- Conti-Ramsden, G., & Durkin, K. (2008). Language and independence in adolescents with and without a history of Specific Language Impairment (SLI). *Journal of Speech, Language and Hearing Research*, 51, 70-83.
- Dockrell JE, Lindsay G, Letchford C, and Mackie C (2006) Educational provision for children with specific speech and language difficulties: Perspectives of speech and language therapy managers. *International Journal of Language and Communication Disorders*, 41, 423-40.
- Fricke, S., Bowyer-Crane, C., Haley, A.J., Hulme, C. & Snowling, M.J., (2013) Efficacy of language intervention in the early years. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*. 54(3), 280-290.
- Gall, F. J. (1822), *Sur les fonctions du cerveau et sur celles de chacune de ses parties: avec des observations sur la possibilité de reconnaître les instincts, les penchans, les talens, ou les dispositions morales et intellectuelles des homes et des animaux, par la configuration de leur cerveau et de leur tête*. Paris: J.B. Baillire.
- Knox, E., & Conti-Ramsden, G. (2003). Bullying risks of 11-year-old children with specific language impairment (SLI): does school placement matter? *International Journal of Language & Communication Disorders*, 38(1), 1-12.
- Law, Roulstone, & Lindsay, 2015 Integrating external evidence of intervention effectiveness with both practice and the parent perspective: development of 'What Works' for speech, language and communication needs. *Developmental Medicine & Child Neurology* 2015, 57(3), 223-228.

- Leonard, C., Eckert, M., Given, B., Virginia, B., & Eden, G. (2006). Individual differences in anatomy predict reading and oral language impairments in children. *Brain*, 129(12), 3329-3342.
- McArthur, G. M., Hogben, J. H., Edwards, V. T., Heath, S. M., & Mengler, E. D. (2000). On the 'specifics' of specific reading disability and specific language impairment. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 41, 869-874.
- Norbury, C. F., Gooch, D., Wray, C., Baird, G., Charman, T., Simonoff, E., ... Pickles, A. (2016). The impact of nonverbal ability on prevalence and clinical presentation of language disorder: evidence from a population study. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*. <https://doi.org/10.1111/jcpp.12573>
- St Clair, M. C., Pickles, A., Durkin, K., & Conti-Ramsden, G. (2011). A longitudinal study of behavioral, emotional and social difficulties in individuals with a history of specific language impairment (SLI). [Article]. *Journal of Communication Disorders*, 44(2), 186-199.
- Stothard, SE., Hulme, C., Clarke, P., Barmby, P., Snowling, M. J. (2010) YARC York Assessment of Reading for Comprehension (Secondary). GL Assessment.
- Whitehouse, A. J. O., Line, E. A., Watt, H. J., & Bishop, D. V. M. (2009). Qualitative aspects of developmental language impairment relates to language and literacy outcome in adulthood. *International Journal of Language and Communication Disorders*, 44, 489-510.